

## FORMULARI NUMËR 3

### KONCEPTDOKUMENTI PËR KRYEPROKUROR

Emri:	SEBAHATE
Mbiemri:	SINANI

Bazuar në kompetencat ligjore të parapara për pozitën që aplikoni, ju lutem të ofroni si vijon:

#### I. Analizën tua:

##### 1. Si e vlerësoni gjendjen aktuale në Prokurorinë e Shtetit?

Syndrom kryesor i Prokurorit të shtetit është luftimi efektiv i krimit në Republikën e Kosovës dhe kontributi në forcimin e sundimit të ligjit dhe se ndër prioritetet kryesore është ndjekja e suksesshme e krimeve të luftës, krimit të organizuar dhe veprave penale që rrënojnë bazat e ekonomisë së vendit. Për të arritur këto objektiva bashkëpunimi me të gjitha organet e zbatimit të ligjit përfshirë Policinë e Kosovës, Doganat e Kosovës, Administratën Tatimore dhe Agjencinë Kundër Korrupsionit, është esencial.

Në këtë drejtim ka shënuar progres dhe ka intensifikuar bashkëpunimin me këto institucione duke nënshkruar edhe marrëveshje bashkëpunimi në fusha të caktuara dhe për qëllime të caktuara.

Viteve të fundit është shënuar po ashtu progres sa i përket rritjes së numrit të prokurorëve dhe angazhimit të stafit mbështetës, e po ashtu është shënuar progres edhe aspekt të organizimit, planifikimit dhe përmirësimit të kushteve të punës. Si rezultat i kësaj por edhe mbështetjes së vazhdueshme nga partnerët ndërkombëtar, lirisht mund të thuhet se Prokurori i shtetit aktualisht gjendet në një fazë të zhvillimit të qëndrueshëm.

Megjithatë për një përmirësim të mëtejshëm të procesit, është e rëndësishme të hartohen plane të analizuara mirë për rritjen e profesionalizmit të prokurëroëve dhe forcimin e llogaridhënieς.

##### 2. Si e vlerësoni gjendjen aktuale në prokurorinë për të cilën keni aplikuar?

Gjendja aktuale në Prokurorinë e Apelit vlerësohet si e mirë. Kjo prokurori viteve të fundit është fuqizuar në mënyrë të ndjeshme, veçanërisht në aspektin e numrit të prokurorëve. Megjithatë duke pas parasysh ndryshimet e fundit ligjore dhe

kompetencat e reja të cilat të kësaj prokurorie, do të jetë e nevojshme të ndërmerren masa për forcimin e mëtejshëm me staf mbështetës profesional.

3. Cilat janë mangësitë dhe sfidat kryesore të kësaj prokurorie?

- Përmirësimi i nivelit të hartimit të vendimeve për sa i përket ankesave të parashtruara;
- Arsyetimi i qartë dhe i saktë i vendimeve si dhe dhënia e udhëzimeve me rekomandime konkrete për prokurorët e shkallës së parë;
- Unifikimi i vendimeve në raport me çështjet e njëjtë për të garantuar koherencë dhe drejtësi në praktikën gjyqësore;

4. A mendoni se strategjitet aktuale të sistemit adresojnë nevojat e prokurorisë për të cilën aplikoni si Kryeprokuror?

Strategjitet aktuale i adresojnë nevojat e përgjithshme të prokurorive në nivel vendi, por kërkohet monitorimi i vazhdueshëm për zbatimin e objektivave dhe aktiviteteve të përcaktuara në to. Pas miratimit të strategjive, prokuroritë duhet të hartojnë planet e veprimit që adresojnë objektivat dhe përcaktojnë prokurorët përgjegjës për realizimin e tyre, nën monitorimin e vazhdueshëm të kryeprokurorit për të finalizuar ato objektiva. Për momentin Prokuroria e Apelit operon në bazë të udhëzimit A.nr.42/2023 të datës 14.02.2024 për procedurat e veprimit me rastin e shqyrimit të ankesave kundër vendimeve të prokurorive themelore dhe PSRK-së në prokurorinë e Apelit, të nxjerrë nga Zyra e Kryeprokurorit të shtetit. Mendoj se ky udhëzim ka nevojë për plotësimet, bazuar në kërkesat e paraqitura në praktikë.

**II. Vizioni juaj për përmirësimin e punës operative në prokurorinë që keni aplikuar?**

Ju lutem listoni/përmendni veprimet tuaja afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata:

1. Cili është vizioni juaj për të përmirësuar punën operative gjatë mandatit tua?

Vizioni im për të përmirësuar punën operative në Prokurorinë e Apelit bazohet në objektiva kyçë të cilat kanë për qëllim që të rrisin efektivitetin, transparencën dhe profesionalizmin e këtij institucionit. Respektimi i të drejtave dhe lirive të individëve gjatë zbatimit të ligjit është parësor, pavarësisht nga pozita apo statusi i tyre. Përmirësimi i kapaciteteve profesionale të prokurorëve dhe të stafit mbështetës është gjithashtu një komponentë thelbësor për zbatimin e suksesshëm të ligjit. Konkretizimi i vizionit dhe qëllimeve sigurisht që do të ndikohet nga rrethanat dhe kushtet aktuale të institucionit.

## 2. Cilat janë objektivat tuaja kryesore?

Përcaktimi i objektivave të mia kryesore do të ketë në fokus administrimin efikas të prokurorisë, duke krijuar kushte adekuate të punës dhe mundësi për zhvillim profesional e fuqizim të llogaridhënieve së prokurorëve dhe personelit mbështetës.

Planifikimi dhe organizimi i punës së Prokurorisë së Apelit me qëllim të përbushjes së mandatit tim ligjor mbështetet në objektivat si në vijim:

Profesionalizmi dhe pavarësia në punë: Për të arritur një nivel të lartë profesionalizmi, do të kujdesem që të gjitha rastet të trajtohen me kompetencë dhe në përputhje me standarde më të mira ndërkombëtare dhe etike. Kjo përfshin jo vetëm trajnimin e vazhdueshëm të prokurorëve për të qenë të përgatitur për sfidat e përditshme, por edhe krijimin e një mjedisi që nxit përmirësimin e performancës, respektimin e procedurave dhe përkushtimin ndaj transparencës dhe drejtësisë, përderisa për të garantuar drejtësi të paanshme dhe vendime të mbështetura në ligj, prokurorët duhet të kenë lirinë të kryejnë punën e tyre pa presion politik apo ndikime të jashtme. Pavarësia është jetike për ruajtjen e besimit të publikut dhe për integritetin e Prokurorisë së Apelit.

Qasje të përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë: Kjo do të arrihet përmes krijimit të një kulture ku secili i punësuar në institucion të përfshihet në identifikimin e mundësive për përmirësim dhe ku inkurajohen idetë e reja. Një mjedis që nxit inovacionin dhe i mbështet prokurorët që të sjellin ide dhe metoda të reja ndihmon në përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së punës.

Mbrojtja e të drejtave të njeriut: Sigurimi që të drejtat dhe liritë e individëve të respektohen dhe mbrohen gjatë procesit penal.

Zhvillimi i kapaciteteve profesionale: Përmirësimi i aftësive profesionale të prokurorëve dhe të stafit për të garantuar një zbatim të ligjit me cilësi të lartë.

Sigurimi i përdorimit të teknologjisë informative: Zhvillimi dhe përdorimi i teknologjisë informative për të përmirësuar efikasitetin dhe transparencën e proceseve.

## 3. Cilat janë sfidat që prisni gjatë përbushjes së këtyre objektivave?

Disa nga sfidat dhe vështirësítë që eventualisht mund të paraqiten, janë:

- Mungesa e burimeve: Për të zbatuar ligjin me sukses, Prokurorët kanë nevojë për burime të mjaftueshme njerëzore, financiare dhe teknologjike.

- Kapacitetet profesionale: Përmirësimi i kapaciteteve profesionale të prokurorëve dhe të stafit mbështetës është një objektiv i rëndësishëm, por mund të kërkojë kohë dhe përpjekje;
- Informacioni dhe teknologjia informative: Përdorimi i teknologjisë informative, mund të jetë sfidë për të siguruar sigurinë dhe integritetin e të dhënave të ndjekura;
- Politikat e brendshme dhe rregullat: Mund të ketë vështirësi në zbatimin e politikave dhe rregullave të brendshme të Prokurorisë.

#### 4. Si do t'i tejkalonit ato?

Përballimi i këtyre sfidave kërkon përkushtim dhe strategji proaktive. Një nga mënyrat më të mira për ti menaxhuar është parashikimi dhe analizimi i sfidave në fazat e hershme. Krijimi i analizave të rregullta dhe identifikimi i mundësive për përmirësim në kohë, do të ndihmojnë në hartimin e strategjive të parandalimit dhe përballimit të sfidave të mundshme.

- **III. Vizioni për të menaxhuar personelin në sistemin prokurorial**

Ju lutem renditni hapat konkretë që do t'i ndërmerrnit gjatë mandatit tuaj:

1. Cili është modeli juaj në menaxhimin e stafit?

Për të avancuar stafin administrativ me sukses, është e rëndësishme të kemi një qasje të strukturuar dhe të kujdesemi për zhvillimin e tyre në një mënyrë që të ndihmojë Prokurorinë të funksionojë më efikas dhe efektivisht.

Kjo mund të arrihet duke i dhënë shembull të mirë stafit, duke treguar profesionalizëm, etikë të fortë dhe angazhim të singertë ndaj punës. Besoj se ky model i udhëheqjes ndihmon në ndërtimin e besimit të fortë dhe i motivon ata të pasojnë shembullin.

Do të përpinqem të siguroj që stafi të ketë informacion të qartë rrëth objektivave, prioriteteve dhe standardeve që duhet të ndjekin.

Do të sigurohem që të kemi sistem të vlerësimit për stafin administrativ dhe se përmirësimi i tyre duhet të jetë një proces i vazhdueshëm, po ashtu do të kujdesem që tu ofroj mundësi avancimi duke i inkurajuar të zbulojnë dhe të implementojnë metodat dhe zgjidhjet e reja që mund të përmirësojnë performancën e prokurorisë;

Stafit administrativ duhet ti ofrohet një mjeshtëri i punës i motivueshëm, ku mund të ndihen të vlerësuar dhe të motivuar për të arritur rezultatet e detyrave të tyre;

Rëndësi do ti kushtohet sidomos stafit me nevoja të veçanta dhe stafit që vijnë nga radhët e komuniteteve jo shumicë në Republikën e Kosovës.

## 2. Si planifikoni ndarjen e barabartë të punës për stafin?

Në bashkëpunim me Administratorin e Prokurorisë do të bëjmë ndarjen e punëve në mënyrë transparente dhe të barabartë duke marrë përbazë rëndësinë e sektorit departament, secili me detyra të caktuara për të siguruar veprim efektiv dhe efikas të prokurorisë.

## 3. Si planifikoni të përmirësoni llogaridhënien dhe profesionalizmin e stafit?

Me qëllim që institucioni i prokurorisë të funksionoj mirë dhe me efikasitet, edhe për stafin sikur për prokurorët vleinë rregullat e llogaridhënieve dhe profesionalizmit. Llogaridhënia dhe profesionalizmi janë pjesë shumë e rëndësishme e parimeve bazë të cilat e karakterizojnë punën e institucionit të prokurorisë.

Do të kërkojmë nga të njëjtat që të detyrat e tyre ti përbushin me profesionalizëm, paanësi, pa diskriminim, në kohë, pa inertes personal dhe në përputhje me ligjin dhe kodin e etikës. Kjo mund të arrihet edhe duke vendosur objektiva të qarta dhe të matshme stafit, ngase në këtë mënyrë krijohet një kuadër i qartë për llogaridhënie. Çdo anëtar i stafit do të ketë të qarta pritshmëritë, standardeve dhe rezultatet e kërkua të përzgjedhura përmes sistemeve të matjes së performancës dhe vlerësimeve të rregullta, bëhet e mundur që secili të ketë përgjegjësi të qartë për punën e vet.

## IV. Hapat që do të ndërmerrni për përmirësimin e integritetit dhe llogaridhënieve së sistemit, prokurorisë dhe besimit të publikut?

Ju lutem listoni/përmendni veprimet tuaja afatshkurtra, afaftimesme dhe afatgjata:

1. Çfarë hapash do të ndërmerrni për të ngritur nivelin e besueshmërisë në Prokurorinë tuaj, duke vënë baraspeshë mes transparencës dhe konfidencialitetit të procedurës?

Për të rritur besueshmërinë e Prokurorisë dhe për të vendosur një balancë mes transparencës dhe konfidencialitetit të procedurave, është e rëndësishme të

ndërmerren hapa të mirë menduar që sigurojnë përputhshmérinë me standartet profesionale dhe pritshmëritë e publikut.

Do të zhvilloj politika të qarta që përcaktojnë se cilat informacione mund të ndahen publikisht dhe cilat duhet të mbeten konfidenciale. Këto politika do t'i bëjnë të qarta kufijtë e transparencës, duke siguruar që publiku të ketë qasje në informacion të rëndësishëm për interesin publik, ndërkohë që mbron të drejtat e palëve dhe proceset hetimore.

Do të komunikoj me publikun në mënyrë të qartë dhe kjo përfshin raportime të rregullta për rezultatet dhe përparimin në çështje të caktuara, duke respektuar njëkohësisht kufizimet që kanë të bëjnë me konfidencialitetin.

Përmes publikimit të raporteve periodike të performancës për Prokurorinë sigurohet transparencë e qëndrueshme. Këto raporte do të përbajnjë statistika mbi numrin e çështjeve të përfunduara, kohën e zgjidhjes së tyre dhe përparimet e tjera të rëndësishme, duke lejuar që publiku të ketë një pasqyrë të qartë mbi arritjet e institucionit.

Këta hapa dhe të tjerë, do të sigurojnë që Prokuroria të operojë me integritet të lartë, duke përbushur detyrat me transparencë dhe konfidencialitet të kujdeshëm, duke rritur kështu besueshmérinë e publikut dhe duke ruajtur standartet profesionale.

## 2. Cilat janë planet tuaja për të siguruar punë cilësore në Prokurorinë tuaj?

Për të siguruar punë cilësore në Prokurorinë time, do të kujdesem që të përcaktoj standarde të qarta që do të udhëzojnë punën në të gjitha nivelet e Prokurorisë. Këto standarde do të mbulojnë aspektet kryesore të punës si përpunimi i rasteve, mbajtja e afateve, dhe përbushja e detyrave me kujdes e përgjegjësi. Krijimi i një mjedisi ku secili është i përgjegjshëm për punën e tij është thelbësor për cilësinë. Për të arritur këtë, do të promovojuj një kulturë llogaridhënieje, ku çdo anëtar i stafit ndjen përgjegjësi për përbushjen e detyrave të tij dhe për rezultatet e arritura.

Teknologja luan një rol të rëndësishëm në përmirësimin e cilësisë dhe efikasitetit të punës. Duke zbatuar në masë të madhe sistemin për menaxhimin e lëndëve SMIL, Prokuroria do të mund të përpunojë rastet me saktësi dhe shpejtësi. Gjithashtu, sistemi do të mundësojë ndjekjen e dokumenteve dhe të dhënavët në mënyrë të sigurtë dhe të shpejtë, gjë që ndihmon në përbushjen e detyrave në kohë dhe në mënyrë të saktë.

Duke zbatuar këto masa, synoj të ndërtoj një Prokurori që operon me cilësi të lartë, efikasitet dhe profesionalizëm, duke arritur kështu rezultatet e kërkuar dhe duke përbushur detyrimet tona ndaj publikut dhe ligjit.

3. Cilat janë planet tuaja për përmirësimin e llogaridhënisë së përgjithshme në Prokurorinë tuaj?


Për të siguruar një llogaridhënie efektive, do të kujdesem që rregullisht ti rishikoj procedurat dhe politikat e brendshme të Prokurorisë. Çdo ndryshim ose përmirësim do të bazohet në rezultatet e monitorimeve dhe feedback-un e marrë, duke synuar arritjen e transparencës dhe llogaridhënisë së Prokurorisë.

Prokuroria duhet të jetë e hapur dhe të publikoj informacionin e saj rrëth veprimtarisë, proceseve dhe vendimeve të tyre. Ky informacion duhet të jetë i qasshëm për publikun, pa e cenuar pavarësinë institucionale duke e ruajtur pavarësinë e plotë nga ndikimet e jashtme dhe politike.

Këto masa do të ndihmojnë në krijimin e një mjedisi ku llogaridhënia dhe përgjegjësia janë shtylla të forta për arritjen e rezultateve cilësore dhe për përbushjen e detyrave tona në mënyrë transparente dhe të drejtë ndaj publikut.

Koncept dokumenti nuk duhet të përbajë më shumë sesa 10 faqe me shkrimin e llojit Book Antiqua, madhësia 12, hapësira njëshe.

Deklaroj se përbajtjen e këtij koncept dokumenti e kam përgatitur vetë dhe jam në dijeni se i njëjtë do të publikohet në uebportali.

Nënshkrimi: 

Datë: 07 nëntor 2024